

VENDIM
Nr.811, datë 13.12.2006

PËR SHLYERJEN E DISA DETYRIMEVE TË NDËRSJELLA TË NDËRMARRJEVE
PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet shuma prej 158 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve dhe minierave, në likuidim dhe konservim, ndaj KESH, sh.a.

2. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet shuma prej 1 070 500 000 (një miliard e shtatëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të ndërmarrjeve të ujësjellësve ndaj KESH, sh.a-së, si dhe shuma prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të ujësjellësve ndaj ISSH-së.

3. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet shuma prej 71 500 000 (shtatëdhjetë e një milionë e pesëqind mijë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të bordeve të kullimit të QTTTB-së, Lushnjë, ndaj KESH, sh.a-së.

4. Fondi prej 1 400 000 000 (një miliard e katërqind milionë) lekësh të përballohet nga fondi i kontigjencës, i planifikuar për vitin 2006.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Bujqësisë dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe ISSH-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha